



*Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!*

**Në këtë buletin do të gjeni:**



***Bashkëpunimi me EU4Rivers***



***26 janar, Dita e e Edukimit Mjedisor***



***Tryezë pune, Modeli i Katërfishtë Heliks – Promovimi i Inovacionit të Gjelbër në Shqipëri***



***Aktiviteti i AKM-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis***



***Konferenca për Parandalimin e Mbetjeve Detare***



***2 Shkurt, Dita Ndërkombëtare e Ligatinave***



***Takim i organizuar nga Inspektorati i Përgjithshëm***



***Raporti për zbatimin e PKMM 2025***



***Strategjia Kombëtare për Ndërgjegjësimin e Publikut dhe Gatishmërinë dhe Komunikimin në situatë krize***



***Veprimtaritë për menaxhimin e kimikateve***



***Vizita Teknike e Delegacionit Shqiptar në Agjencinë Evropiane të Mjedisit***



***Trajnimi “Stop vend-depozitimeve të parregullta”***



***Fushata për pastrimin e bregdetit***



***Ndërgjegjësimi për një mjedis të pastër gjatë sezonit veror 2026***



***Edukimi mjedisor në shkollat 9- vjeçare***



***Dita botërore për sigurinë dhe shëndetin në punë***

## Bashkëpunimi me EU4 Rivers

1. Në kuadër të zbatimit të projektit **EU4Rivers**, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishte e pranishme në takimin lançues për komponentin 4 të projektit: “Krijimi i një kuadri strategjik dhe institucional për zbatimin e Direktivës Kuadër për Strategjinë Detare (MSFD) në 20 Janar 2026.

### Objektivat e takimit ishin:


- Prezantimi i komponentit detar, lidhja e tij me rezultatet e projektit EU4Rivers dhe kontributi në Kapitullin 27 (Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike) të procesit të anëtarësimit në BE;
- Prezantimi i aktiviteteve të planifikuara në kuadër të këtij komponenti;
- Përcaktimi i mekanizmave të koordinimit dhe qartësimi i roleve institucionale ndërmjet aktorëve kyç;
- Nxitja e angazhimit institucional përmes dialogut dhe planifikimit të zhvillimit të kapaciteteve.

Përfaqësimi i institucionit tone në takim konsiderohet shumë i rëndësishëm për shkak të kontributit që AKM-ja do të japë gjatë zbatimit të **komponentit 4 të projektit** që do të kulminojë me zhvillimin e Strategjive Detare për detet Adriatik dhe Jon.



2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishte pjesëmarrëse në workshopin për “Monitorimin e Cilësisë së Ujit” organizuar nga EU4Rivers dhe AMORE-AL me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në sektorin e menaxhimit të ujërave, me synim mbështetjen e zhvillimit të një udhërrëfyesi për ngritjen e kapaciteteve.

Aktiviteti përfshiu prezantimin e rezultateve nga veprimtaritë e mëparshme dhe ato në vijim, të realizuara nga BOKU, EU4Rivers dhe AMORE-AL, përfshirë workshop-et e zhvilluara me institucionet kombëtare dhe akademike në Shqipëri.



Gjithashtu, u ndanë përvoja rajonale mbi rolin e universiteteve në përgatitjen e ekspertëve të sektorit të ujit, përfshirë kontributin e Universitetit të Prishtinës. Përmes diskutimeve të strukturuar në grupe, u analizuan modelet e organizimit të trajnimeve profesionale në Shqipëri, si dhe rolet dhe

kualifikimet e pritshme të ekspertëve të Menaxhimit të Cilësisë të Ujit.

Workshop-i përfundoi me dakordësimin mbi hapat e ardhshëm dhe veprimet prioritare, të cilat do të kontribuojnë në hartimin e një plani të qëndrueshëm për ndërtimin e kapaciteteve, duke marrë në konsideratë edhe zhvillimin e programeve të reja akademike, përfshirë programin e ri master në menaxhimin e menaxhimit të ujërave që pritet të nisë në AUT në vjeshtë 2026.

3. Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është angazhuar me Projektin EU4Rivers i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe Zbatohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).

Janë zhvilluar fushatat kampionuese në Lumin Mat dhe Ishëm për vlerësimin e statusit ekologjik të tyre nëpërmjet identifikimit të makroinvertebrorëve, si dhe vlerësimin e statusit kimik në përputhje me kërkesat e DKU. Në këto ekspedita ka qenë i pranishëm edhe eksperti Z. Reinder Torenbeek.



### 26 Janar, Dita e Edukimit Mjedisor

Kjo ditë ka si qëllim të edukojë brezat e rinj që ta duan mjedisin. Në këtë kontekst, Agjencia Kombëtare e Mjedisit organizoi orë edukative për mjedisin në shkollat 9-Vjeçare “Faik Konica” dhe “Kristaq Rama” me synim rritjen e njohurive mbi çështjet mjedisore dhe përfshirjen aktive të nxënësve në mbrojtjen e mjedisit



Nxënësit u informuan mbi rëndësinë dhe përfitimet e edukimit mjedisor si dhe veprimet që mund të bëjnë për përmirësimin e mjedisit. Fëmijët nëpërmjet posterit me temë “Unë dhe Mjedisi” prezantuan idetë e tyre se si mund të kujdesen dhe ta mbrojnë mjedisin



## Tryezë pune, Modeli i Katërfishtë Heliks – Promovimi i Inovacionit të Gjellbër në Shqipëri

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishte pjesëmarrëse në tryezën e punës për Promovimin e Inovacionit të Gjellbër organizuar nga GREENSMED.

### Vizioni i Projektit:

Projekti GREENSMED synon të modernizojë dhe promovojë inovacionin e gjellbër tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME) përmes praktikave dhe mjeteve transnacionale bashkëpunuese. Qëllimi është të zhvillohet një zgjidhje e integruar që ndihmon bizneset të rrisin konkurrueshmërinë e tyre në mënyrë të matshme.

### Objektivat Kryesore të Diskutuara:

Ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi: Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i bashkëpunimit mbi inovacionin e gjellbër.

Reduktimi i boshllëqeve në inovacion: Transferimi i teknologjive të përmirësuara dhe adoptimi i teknologjive të reja nga Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla.

Rritja e kapaciteteve dhe njohurive: Zhvillimi i njohurive dhe aftësive të palëve të interesuara për të nxitur rritjen dhe inovacionin e qëndrueshëm.

### Pika Kyçe të Diskutimit:

Bashkëpunimi dhe ndarja e njohurive janë thelbësore për suksesin e projektit.

Përdorimi i mjeteve praktike do të mundësojë që Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla të adoptojnë praktika më të gjelbra, duke ruajtur konkurrueshmërinë në treg.

## Aktiviteti i AKM-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Një nga veprimtaritë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është shqyrtimi Teknik i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Gjatë periudhës janar-Prill janë kryer aktivitetet e mëposhtme;

- ✦ Për muajin Janar ka pasur 229 aplikime të shqyrtuar, nga të cilat janë dhënë 67 Vendime për VNM Paraprake, 4 Vendime për Ente publike, dhe 6 Deklaratë Mjedisore.
- ✦ Për muajin Shkurt ka pasur 178 aplikime të shqyrtuar, nga të cilat janë dhënë 29 Vendime për VNM Paraprake, 2 Vendime për Ente publike, dhe 4 Deklaratë Mjedisore.
- ✦ Për muajin Mars ka pasur 251 aplikime të shqyrtuar, nga të cilat janë dhënë 73 Vendime për VNM Paraprake, 7 Vendime për Ente publike, dhe 2 Deklaratë Mjedisore.
- ✦ Për muajin Prill ka pasur 365 aplikime të shqyrtuar, nga të cilat janë dhënë 160 Vendime për VNM Paraprake, 15 Vendime për Ente publike, dhe 2 Deklaratë Mjedisore.

Në total ka pasur 1023 aplikime të shqyrtuar, nga të cilat janë dhënë 329 Vendime për VNM Paraprake, 28 Vendime për Ente publike, dhe 14 Deklaratë Mjedisore.

## Konferenca për Parandalimin e Mbetjeve Detare

Në datë 29 -30 Janar në hotel Maritim Plaza, Tiranë, u zhvillua konferenca finale e projektit rajonal për Parandalimin e Mbetjeve Detare i zbatuar nga GIZ në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Mali i Zi.


Kjo konferencë theksoi :

Nga veprimet pilot drejt ndikimit rajonal


Çfarë vjen më pas: vazhdimësia dhe projektet e reja rajonale Shkëmbim dhe dialog mbi të ardhmen e Ekonomisë Qarkulluese në Ballkanin Perëndimor



Gjatë ditës së parë u prezantuan arritjet dhe rezultatet e projektit të parandalimit të mbetjeve në vendet e Ballkanit. Eksperiencat në lidhje me ekonominë qarkulluese nga kompani të ndryshme si; sistemi i depozitës së rikthimit të materialeve të riciklueshme, menaxhimi i paketimeve prej qelqi, riciklimi i qelqit. Gjithashtu u mbajtën edhe prezantime mbi rrjetin e bashkëpunimit rajonal në fushën e ekonomisë qarkulluese.



Në ditën e dytë u mbaj prezantimi mbi mënyrat se si e nxit ekonomia qarkulluese udhëtimin e Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE, duke vijuar me panelin me tematikë “Tranzicioni rrethor në Ballkanin Perëndimor, gatishmëria, partneritetet dhe perspektiva e BE.



Konferenca vazhdoi me një hapësirë me grupe tematike të ndryshme për shkëmbim eksperience, inspirim apo lidhshmërinë ndërmjet vendeve në lidhje me bashkëpunimin rajonal për ekonominë qarkulluese, mundësitë dhe sfidat.

Rezultatet e diskutimeve të grupeve u paraqitën në një raport të shkurtër për secilën tematikë.

## 2 Shkurt, Dita Ndërkombëtare e Ligatinave

Qëllimi i kësaj dite është rritja e ndërgjegjësimit dhe inkurajimit të veprimeve për t'i ruajtur

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Rajonale të Mjedisit- Fier-Vlorë-Gjirokastrë dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit -Shkodër-Lezhë-Kukës ka organizuar fushatë pastrimi në terrenet e Lagunave Kune-Vain, Nartë dhe Karavasta me synim ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre,



Ligatinat kanë një rol shumë të rëndësishëm në ekosistem duke kontribuar në:

- ✓ Ruajtjen e biodiversitetit.
- ✓ Filtrimin natyror të ujit (pastrimin e ujit nga ndotësit)
- ✓ Mbrojtjen e sedimenteve.
- ✓ Uljen e sasisë të kimikateve dhe mbetjeve. Si pasojë kemi mbrojtjen e lumenjve dhe deteve.
- ✓ Parandalimin e përmblytjeve.
- ✓ Rregullimin e klimës duke ruajtur karbonin në tokë dhe ndihmojnë në uljen e ngrohjes globale.
- ✓ Mbrojtjen për peshkimin dhe bujqësinë. Peshqit shumohen nga prania e ligatinave. Ato ndihmojnë edhe në ujitjen e tokave dhe përmirësimin e pjellorisë së tokës.
- ✓ Mbrojtjen nga erozioni pasi rrënjët e bimëve nga ligatinat mbajnë tokën të qëndrueshme dhe parandalojnë shkatërimin e brigjeve.
- ✓ Zhvillimin e Turizmit. Ligatinat janë edhe zona të bukura natyrore që ndikojnë në turizmin ekologjik.



## Takim i organizuar nga Inspektorati i Përgjithshëm

Takimi i zhvilluar më datë 01.04.2026, i organizuar nga Inspektori i Përgjithshëm, kishte si qëllim prezantimin dhe diskutimin e reformës së Inspektoratit të Përgjithshëm (IP), me synim unifikimin e sistemit të inspektimeve dhe përfshirjen në të ardhmen, të strukturave të inspektim-kontrollit nën varësinë e Inspektoratit të Përgjithshëm.

Në këtë kuadër, u kërkua pjesëmarrja e gjerë e institucioneve, përfshirë edhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, si pjesë e strukturave që pritet të integrohen në këtë reformë.



Drejtorja e Inspektimit Kontrollit (DIK) ishte e përfshirë drejtpërdrejt në këtë proces, duke patur një prezencë të plotë të inspektorëve, bazuar në rëndësinë e rolit të saj në kuadër të reformës së propozuar. Pjesëmarrja e DIK në takim synonte jo vetëm përfaqësimin institucional, por edhe angazhimin aktiv në diskutimet mbi riorganizimin dhe standardizimin e funksioneve të inspektimit në nivel kombëtar.

## Raporti për zbatimin e PKMM 2025



Programi Kombëtar i Monitorimit Mjedisor hartohet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe përfshin informacione në lidhje me treguesit mjedisor që duhet të monitorohen, vendi i kampionimit, parametrat përkatës, frekuenca e monitorimit, paraqitja e të dhënave si dhe institucionet monitoruese. Monitorimi i mjedisit siguron rezultate për vlerësimin e gjendjes në mjedis si dhe të ndikimit të aktivitetit njerëzor në mjedisin natyror.

Për këtë qëllim, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer një Mjedisit (PKMM) për vitin 2025. Synimi kryesor është identifikimi i treguesve mjedisor dhe i stacioneve të monitorimit që janë monitoruar apo nuk janë monitoruar. Mbi bazën e rezultateve të gjetura arrihet të shihet një vështrim i përgjithshëm mbi zbatueshmërinë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2025 dhe sfidat për përmirësimin e monitorimit mjedisor.

Ky raport do të shërbejë si një element thelbësor për rritjen e kapaciteteve teknike e financiare si dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional për monitorimin e të gjithë treguesve mjedisor sipas rrejtës të stacioneve të monitorimit të përcaktuar në PKMM 2025.

Gjithashtu do të nxisë politikëbërësit të ndërmarrin veprime apo masa për zhvillimin e kuadrit ligjor apo mekanizmave të ndryshme në funksion të përmirësimit të monitorimit mjedisor

### Strategjia Kombëtare për Ndërgjegjësimin e Publikut dhe Gatishmërinë dhe Komunikimin në situatë krize

Më datë 23 Prill 2026, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me Agjencinë Suedeze, institucione qendrore, institucione vendore, shoqëri civile, për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Ndërgjegjësimin e publikut dhe Gatishmërinë dhe Komunikimin në situatë krize, organizuan takimin me temë “Strategjia Kombëtare për Ndërgjegjësimin e Publikut dhe Gatishmërinë dhe Komunikimin në situatë krize”.



Takimi mbledhi përfaqësues nga institucione publike dhe organizata të ndryshme, me qëllim krijimin e një platforme bashkëpunimi dhe shkëmbimi idesh për përmirësimin e komunikimit në situata emergjente. Në këtë takim ishin edhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Gjatë takimit u prezantuan çështjet si më poshtë vijon:

- Kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, organizimi i takimeve me grupet e punës për parashikimin e situatave të krizës dhe emergjente dhe masat që duhet të marrin për ndërgjegjësimin e publikut.
- Krijimin e kuadrit koherent që forcon aftësinë e Shqipërisë për të komunikuar në mënyrë sa më efektive në situata krize-para/gjatë krizës dhe pas krizës.
- Shqipëria që prej vitit 2022 është shtet pjesëmarrës në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile BE dhe ndihmesa e ofruar në situata emergjente.



Gjatë workshop-it u prezantua projekti REAGO dhe u zhvilluan diskutime dhe punë në grup për:

- identifikimin e prioriteteve dhe sfidave
- përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi
- përmirësimin e koordinimit ndër-institucional
- përafrimin me praktikën dhe standardet e Bashkimit Evropian

Projekti REAGO, i ndërmarrë nga AKMC, kishte si qëllim informimin në kohë reale.

Gjatë takimit u organizuan pyetësorë duke hapur debat në lidhje me mesazhet informuese nëse duhet të jenë të thjeshta apo të detajuara për të shmangur keqkuptimet, nëse duhet të jenë të bashkërenduara nga institucionet për një komunikim publik.

U ndanë pjesëmarrësit në 4 grupe duke dhënë shembuj të situatave të krizës në të cilën janë hasur, çfarë njoftimesh kanë kryer për institucionet kompetente si edhe sa pranë i janë gjendur publikut.

Takimi shënoi hapin e parë të një procesi me disa faza, për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit, duke theksuar rëndësinë e kontributit të aktorëve për një qasje të unifikuar dhe efektive në komunikimin në situatë krize.

### Veprimtaritë për menaxhimin e kimikateve

Gjatë periudhës Janar–Prill 2026, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka vijuar aktivitetin e saj me fokus në forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e kimikateve dhe mbrojtjes së mjedisit.

Vijimi i përditësimit të Helpdesk-ut dhe faqes zyrtare të kimikateve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe asistencës për prodhuesit, importuesit dhe subjektet e interesuara mbi detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për kimikatet.

Në kuadër të bashkëpunimit me Agjencinë Evropiane të Kimikateve (ECHA) dhe organizata të tjera ndërkombëtare, përfaqësuesit e AKM-së morën pjesë në një sërë takimesh dhe trajnimesh teknike, ndër të cilat:

- HelpNet REACH Videoconference (26 mars 2026);
- Takimi i 56-të i Autoriteteve Kompetente për REACH dhe CLP (CARACAL-56);
- Webinar rajonal për menaxhimin e PCB-ve (12 shkurt 2026);
- Trajnimi i ECHA për vlerësimin e riskut dhe efikasitetit për vendet IPA (25 mars 2026);
- Takime dhe webinarë në kuadër të Konventës së Roterdamit mbi asistencën teknike dhe përdorimin e databazave dhe mjeteve të konventës.

Në kuadër të Konventës së Roterdamit, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (DNA) vijoi procedurat për verifikimin dhe përgatitjen e përgjigjeve lidhur me procedurën PIC, në zbatim të VKM nr. 665, datë 21.09.2016 “Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”. Gjithashtu, më 31 mars 2026 u plotësua pyetësori i Sekretariatit për zbatimin e Konventës, duke kontribuar në shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale, si dhe në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe praktikave kombëtare me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e menaxhimit të kimikateve.



Pjesëmarrje në takimin nën-rajonal të Programit Med (MedProgramme) të Konventës së Barcelonës 21 -22 Prill 2026. Objektivi kryesor i takimit ishte identifikimi i iniciativave të tjera të vazhdueshme në fushën e menaxhimit të integruar të zonës bregdetare, menaxhimit të integruar të ujit, kimikatet dhe mbetjet, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtjes së biodiversitetit me potencial replikimi/zgjerimi në vendet përkatëse ose në nivel ndërkufitar.



Ky takim dy-ditor mbledhi palët e interesuara shqiptare që punojnë në katër Fushat Fokale të Programit MedProgram GEF (Kimikatet dhe Mbetjet, Ujërat Ndërkombëtare, Ndryshimet Klimatike, Biodiversiteti), si dhe një Delegacion nga Mali i Zi dhe një Delegacion nga Bosnja -Hercegovina, secila e përfaqësuar përkatësisht nga një numër ekspertësh në këta sektorë.

### Vizita Teknike e Delegacionit Shqiptar në Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA)

Në datat: 21–23 Prill 2026, Kopenhagen u zhvillua vizita teknike e Delegacionit Shqiptar organizuar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit si dhe Agjencia e Eficiencës së Energjisë.

#### Qëllimi i vizitës

Vizita u zhvillua në kuadër të projektit të Komunitetit të Energjisë dhe synoi forcimin e kapaciteteve të Shqipërisë për raportimin e klimës dhe energjisë sipas rregulloreve të BE-së. Delegacioni shqiptar mori mbështetje praktike për sistemet kombëtare të raportimit, përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe përafrimin me platformat e BE-së (Reportnet 3, UNFCCC).

#### Dita 1 – Sistemet Kombëtare të Qeverisjes dhe Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës

Dita e parë filloi me prezantimin e mirëseardhjes si dhe me një tur në ambientet e Agjencisë Evropiane të Mjedisit. Më pas vijoi me një prezantim nga pala shqiptare mbi sistemet e raportimit për inventarin e GHG, politikat dhe masat (PaMs), si dhe veprimet e adaptimit. Nga pala pritëse u vijua me prezantime mbi shkëmbimin e përvojave me vendet anëtare të BE, përfshirë shembullin e Danimarkës.

Dita e parë u mbyll me diskutime mbi lidhjen e PaMs me projeksionet e GHG dhe objektivat kombëtare, si dhe koordinimin ndërinstitucional.

#### Dita 2 – Inventarët e GHG dhe Progresi drejt Objektivave

Në ditën e dytë fokusi kryesor ishte mbi hartimin e inventareve të gazeve serrë ku pati prezantime mbi përdorimin e produkteve Copernicus dhe matricën LULUCF.

U punua në sesionin praktik mbi raportimin e flukseve të të dhënave të papërfunduara (inventarë, projeksione, financim klimatik, adaptim), detyrime mbi REPORTNET 2 dhe REPORTNET 3.

Dita e dytë u mbyll me diskutime mbi raportimin e progresit drejt objektivave të GHG sipas Aneksit I, me praktikat më të mira dhe sfidat e vendeve anëtare.



#### Dita 3 – Statistikat e Energjisë dhe Adaptimi

Dita e fundit e takimit filloi me udhëzime nga EUROSTAT për përmirësimin e disagregimit sektorial në statistikën e energjisë dhe cilësinë e të dhënave të ardhshme, ku takimit iu bashkua online edhe përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, ekspert i cili raportonte të dhënat mbi bilancin energjistik në EUROSTAT.

Më pas diskutimi vijoi mbi bashkëpunimin strategjik EEA–Shqipëri dhe mundësitë e sinergjive, ku pati një prezantim nga znj. Luna Kalas e grupit të Komunikimit dhe Qeverisjes si dhe koordinatoresha e Pikës Fokale të Shqipërisë Znj. Orjana Hanxhari. Fokusi kryesor i këtij sesioni ishte që të rrisim sa më shumë numrin e raportimeve nëpërmjet platformës EIONET.

Gjatë pjesës së dytë u prezantua platforma Climate-ADAPT si mjet për politikën e adaptimit dhe raportimin sipas nenit 17 të NECP si dhe u paraqitën rekomandime për rritjen e transparencës dhe krahasueshmërisë në raportimin e objektivave të adaptimit.

#### Rezultatet e arritura gjatë këtij takimi janë:

- Rritja e njohurive mbi praktikën e vendeve anëtare të BE për raportimin e klimës dhe energjisë.
- Mbështetje praktike për përfundimin e flukseve të të dhënave të papërfunduara.
- Përmirësim i kuptimit mbi metodologjitë e statistikave të energjisë dhe përafrimi me standardet e EUROSTAT.
- Thëllimi i bashkëpunimit institucional me EEA dhe identifikimi i mjeteve të reja për mbështetje.

#### Rekomandime për institucionet të cilat kanë detyrim raportimi mbi këto fusha janë:

- Të forcohet koordinimi ndërinstitucional për raportimin e PaMs dhe projeksioneve të GHG.
- Të përshejtohet integrimi i sistemeve kombëtare me platformat e BE-së (Reportnet 3).
- Të sigurohet cilësia dhe konsistenca e statistikave të energjisë përmes metodologjive të EUROSTAT.
- Të përdoret platforma Climate-ADAPT për hartimin e politikave të adaptimit dhe raportimin sipas nenit.

## Trajnimi “Stop vend-depozitimeve të parregullta”

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, së bashku me Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë-Durrës-Dibër, morën pjesë në vizitën studimore dhe trajnimin me temë “Stop vend-depozitimëve të parregullta”, zhvilluar në Selanik, Greqi, më 23–24 prill 2026.



Në ditën e parë u realizuan vizita në terren. Fillimisht u vizitua ish-landfilli i Tagarades, ku aktualisht operon një njësi për prodhimin e energjisë nga biogazi, si shembull i rikuperimit funksional të një venddepozitimi të mëparshëm.

Landfilli i Tagarades:

- Hapur më: 1981
- Mbyllur më: 2008



Flora e parkut është veçanërisht e pasur, me shkurre, pemë dhe bimë aromatike që krijojnë një oaz të gjelbër të harlisur. Lëndinat e mirëmbajtura janë ideale për piknik, duke ofruar një arratisje të qetë nga jeta e përditshme.

### Trajtimi i lixiviatit (Leachate Treatment)

Metoda të ndryshme janë të disponueshme në varësi të karakteristikave të lixiviatit. Lixiviatet me përbërje të ndryshme kërkojnë metoda trajtimi të personalizuar ose kombinime të tyre



Metodat e trajtimit të përdorura në Tagarades LTP përfshijnë:

- **Ajrosje (Aeration)**  
Reduktimi i lëndës organike.
- **Precipitimi, ndarës me lamela**  
Vendosja (ulja) e substancave inorganike të tretura dhe e materialeve të pezulluara.
- **Osmoza e kundërt (Reverse Osmosis)**  
Ndarja e ujit nga substancat e tretura (kripërat) në enë me membranë.
- **Avullimi (Evaporation – aktualisht jo funksional)**  
Avullimi dhe rikondensimi i koncentratit të RO duke përdorur shkëmbyes nxehtësie.



Më pas u zhvillua vizita në **Thermi Environmental Park**, një landfill i rehabilituar dhe i transformuar në hapësirë publike rekreative. Parku Mjedisor i Thermit është një shembull i shkëlqyer i restaurimit mjedisor dhe hapësirës rekreative, i krijuar në një ish-vend depozitimi mbetjesh. Sot, ai shërben si një zonë mahnitëse për relaksim dhe aktivitet fizik, duke u ofruar vizitorëve një mundësi për të shijuar natyrën afër mjedisit urban. Ky park ofron një shumëllojshmëri ambientesh si për fëmijë ashtu edhe për të rritur. Një kënd lojërash prej druri shumëngjyrësh ofron argëtim të pafund për vizitorët.

Në ditën e dytë, takimi u zhvillua në ambientet e Shoqatës Rajonale të Agjencive të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta të Maqedonisë Qendrore. Programi përfshiu prezantime mbi raste konkrete, duke krahasuar një rast të suksesshëm me një rast problematik, me fokus në identifikimin e problematikave dhe faktorëve kyç.



Ky aktivitet dha një kontribut të frytshëm drejt përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve dhe forcimit të praktikave për rehabilitimin e venddepozitimeve të paligjshme.

## Fushata për pastrimin e bregdetit

*Të mbroymë mjedisin dhe bregdetin tonë, së bashku!*

Kjo ishte motoja e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në angazhimin në datë 25 Prill 2026 për pastrimin dhe ruajtjen e bregdetit shqiptar, një pasuri e çmuar natyrore që i përket të gjithëve. Përmes aksioneve të pastrimit, ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me komunitetin, synojmë të reduktojmë ndotjen dhe të mbroymë biodiversitetin detar.



♻️ Çdo mbetje e hedhur pa kujdes dëmton ekosistemin dhe bukurinë e brigjeve tona.

- 📍 Mos hidhni mbeturina në natyrë
- ♻️ Ricikloni sa herë që është e mundur
- 🚰 Merrni pjesë në aktivitetet e pastrimit
- 🌿 Një bregdet i pastër sot do të thotë një e ardhme më e shëndetshme për brezat që vijnë.

### Ndërgjegjësim për një mjedis të pastër gjatë sezonit veror 2026

Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Bashkitë Vlorë, Pogradec dhe Durrës ka organizuar takime me tematikë "Ndërgjegjësim për një mjedis të pastër gjatë sezonit veror 2026".

Qëllimi i takimeve ishte:

1. Informimi për cilësinë e ujërave për zonat bregdetare si dhe identifikimi i zonave me ndotje të lartë mikrobiale.
2. Përmirësimin e cilësisë të ujërave të larjes nëpërmjet marrjes së për trajtimin e ujërave urbane, para se ato të shkarkohen në ujërat pritëse.
3. Sigurimi i një mjedisi të pastër higjeno-sanitar nëpërmjet nxitjes së marrjes së masave nga bashkia për vendosjen e tualeteve, shtimin e koshave të mbeturinave në plazhet publike.

Pjesëmarrës në takime ishin përfaqësues të bashkisë si dhe institucioneve të tjera, bizneset, kryesisht hotele, bar-restorante.



Përfaqësuesit e AKM prezantuan:

- Vlerësimin për plazhet sipas stacioneve për çdo bashki duke theksuar plazhet e ndotura me ngarkesë mikrobiale të lartë që i përkasin kategorisë D- Cilësi e keqe masa të menjëhershme si dhe faktorët që kanë ndikuar në ndotjen e tyre.
- Vlerësimi higjeno-sanitar në stacionet e monitoruara në plazhe.
- Rekomandimet për përmirësim në lidhje me shkarkimet e ujërave urbane, menaxhimin e mbetjeve urbane dhe inerte dhe ruajtjen e rregullave higjeno- sanitare .

Gjatë takimeve u diskutuan problematika të ndryshme në lidhje me ndotjen e ujërave detare dhe ndikimi në mjedis dhe shëndet. U trajtuan çështjet për shkarkimet e ujërave të zeza në det, bashkimi i ujërave të bardha dhe të zeza të cilat përbëjnë një ndotje të lartë mikrobiologjike.



Trajtimi i ujërave të ndotura nëpërmjet impianteve nuk është i plotë, pasi pjesa më e madhe e impianteve kanë vetëm trajtimin parësor dhe nuk kryejnë trajtimin dytësor dhe tretësor. Shtimi i ndërtesave përbën gjithashtu një problem për ndotjen e ujërave bregdetare si pasojë e shkarkimeve të ujërave të ndotura.

U theksua rëndësia e bashkëpunimit të institucioneve përgjegjëse për përmirësimin e situatës.

### Edukimi mjedisor në shkollat 9- vjeçare

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka organizuar orë edukative me nxënës të shkollave 9- vjeçare "1 Maji" dhe "Sabaudin Gabrani" për një temë shumë të rëndësishme: "Ndotjen e ajrit dhe efektet e saj në shëndet". Zhvillimi i edukimit mjedisor synoi njohjen e nxënësve me burimet e ndotjes së ajrit dhe efektet në shëndet dhe rritjen e ndërgjegjësimin për mbrojtjen e ajrit.



Nxënësit u angazhuan, diskutuan dhe ndanë ide se si mund të kontribuojmë për një mjedis më të pastër. Ndotja e ajrit është një nga sfidat më të mëdha për shëndetin tonë, sidomos për fëmijët.



Përmes aktiviteteve në shkollë, rrisim ndërgjegjësimin mbi ndikimin që ajri i ndotur ka në jetën dhe shëndetin tonë si dhe rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

## Dita botërore për sigurinë dhe shëndetin në punë

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ishte pjesë e eventit të organizuar nga HSEM, 28 Prill 2026, në kuadër të ditës botërore për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Ky event ishte programuar për të përfshirë:

- Sigurinë në punë -nga teoria në praktikë
- Vizitë në parkun industrial BREMA
- Trajnim, mbrojtja nga zjarri
- Banket dhe networking

Një përmbledhje të diskutimeve me interes ishin përfundimet:

Legjislacioni në fuqi në Shqipëri për sigurinë dhe shëndetin në punë sjell disa përfitime të drejtpërdrejta si për punëmarrësit, ashtu edhe për punëdhënësit:

Së pari, ai garanton mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve, duke vendosur standarde të detyrueshme për kushte të sigurt pune, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse dhe parandalimin e rreziqeve profesionale.

Së dyti, ndihmon në uljen e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, pasi kërkon identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës.

Gjithashtu, rrit ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e punëdhënësve dhe punëmarrësve për sigurinë, duke përfshirë trajnime të detyrueshme dhe informim të vazhdueshëm.

Nga ana ekonomike, përmirëson produktivitetin dhe ul kostot për bizneset, duke shmangur humbjet nga aksidentet, mungesat në punë dhe dëmshpërblimet.

Në të njëjtën kohë, legjislacioni shqiptar është i harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian, çka ndihmon në rritjen e cilësisë së kushteve të punës dhe përmirëson imazhin e kompanive në treg.

Në përmbledhje, ky legjislacion krijon një mjedis pune më të sigurt, më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm për të gjithë. Në fund të eventit u pajisëm edhe me një manual për sigurinë dhe shëndetin në punë.

